



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.707/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtaren Shpresa Veselaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Qamil Zeka nga fshati Bardhosh, Komuna e Prishtinës, të cilin e përfaqëson me prokurë Ilir Gashi, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Denisa Carla, shtetase e Rumanisë, tani me adresë të panjohur, për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim, duke vendosur sipas propozimit të paditësit për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurën, jashtë seancës gjyqësore me datën 09.07.2021 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Të paditurës Denisa Carla, shtetase e Rumanisë, tani me adresë të panjohur i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm Lulzim Krasniqi, avokat në Prishtinë, i cili ka për obligim që të paditurën ta përfaqësoj në procedurën për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim në lëndën C.nr.707/19.

II. Sipas dispozitës së nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron deri sa të paraqiten në gjykatë të paditurit apo përfaqësuesit e tyre me prokurë, gjegjësisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftojë gjykatën se iu ka caktuar kujdestarin.

III. Ky aktvendim do të shpallet në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe në Tabelën e shpalljeve të gjykatës.

A r s y e t i m

Paditësi përmes përfaqësuesit të tij, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi me datë 11.03.2019, kundër të paditurës Denisa Carla, shtetase e Rumanisë, tani me adresë të panjohur, për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim.

Gjykata ka caktuar seancën përgatitore me datë 03.06.2021, në të cilën seancë ka prezantuar përfaqësuesi me prokurë i paditësit, ndërsa për të paditurën askush nuk ka prezantuar në seancë, andaj me qëllim që çështja të mos zvarritet nga ana e të paditurës, paditësi i propozoi gjykatës që të caktohet përfaqësuesi i përkohshëm, sipas dispozitës së nenit 79.3 të LPK-së, për të paditurën Denisa Carla, shtetase e Rumanisë, tani me adresë të panjohur.

Duke vendosur sipas propozimit të paditësit, gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 79 par. 3 pika (a) të LPK-së, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurën.

Andaj, gjykata vendosi që të paditurës, t'i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm Lulzim Krasniqi, avokat nga Prishtina nga lista e avokatëve të Odës së Avokatëve të Kosovës, i cili do t'i përfaqësojë interesat e të paditurës në këtë çështje juridiko-civile.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
C. nr. 707/19 dt. 09.07.2021

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

